

SHPJEGUESE¹

PËR

Vendimin, Nr.5, Datë29.12.2014

PËR IDENTIFIKIMIN E ZONAVE TË URBANIZUARA NË TË GJITHË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MIRATIMIN E HARTAVE KU MUND TË NDËRHYHET NË FUNKSION TË ZHVILLIMIT URBAN

Evidentimi i zonave të urbanizuara është realizuar nëpërmjet qarkimit të sipërfaqeve të tokës, të cilat rezultojnë të ndërtuara, pasi tashmë e kanë humbur funksion e tyre primar të prodhimit bujqësor apo të kategorive të ngjashme, për shkak të veprimtarisë ndërtimore që është ushtruar mbi to.

Gjithashtu, janë përfshirë në zonat e urbanizuara edhe ato sipërfaqe, të cilat rrethohen ose lidhin me njëra-tjetrën, sipërfaqe të ndërtuara të gjendura fare pranë, duke mundësuar kështu krijimin e grupimeve kompakte gjithandej ku zhvillimi urban i pakontrolluar ka ndryshuar karakterin e territorit duke mos lenë mundësi të ardhme për një zhvillim tjetër (bujqësor, natyror, e të ngjashme) përveç atij urban.

Vija qarkuese e këtyre zonave do të konsiderohet "Kufi i Zonës së Urbanizuar". Në territorin brenda këtij kufiri mund të procedohet me ndërhyrjet në funksion të zhvillimit urban. Këto zhvillime urbane duhet të jenë në përputhje me bazën ligjore në fuqi.

Kufiri i zonave të urbanizuara do të konsiderohet si një **‘fashë e ndërmjetme’ midis dy zonave/territoreve**, atij të urbanizuar tashmë (territori i qarkuar) dhe territorit natyral, apo i një kategorie tjetër, por i pandërtuar. **Koncepti i ‘fashës’ nënkupton që kufiri nuk është një linjë, por në vetvete një sipërfaqe (territor i ndërmjetëm). ‘Fasha e ndërmjetme’ do të ketë një gjerësi 15m.**

Në rastet kur prona/ parcela nuk ndodhet tërësisht brenda territorit të qarkuar si zonë e urbanizuar, duhet aplikuar koncepti i ‘fashës së ndërmjetme’. **Në rast se, mbi 70% e pronës ndodhet brenda zonës së urbanizuar dhe fashës së ndërmjetme, prona konsiderohet brenda zonës së urbanizuar.**

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit

Iniciuese e këtij koncepti

Propozuese në KKT për miratimin e këtij vendimi

¹ <http://www.planifikimi.gov.al/?q=sq/content/dt-29122014-vendim-nr-5>